

URDHËR
Nr. 327, datë 8.7.2022

**PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN “MBI PËRCAKTIMIN E
KRITEREVE DHE KËRKESAVE PËR CERTIFIKIMIN VETERINAR TË DISA
LLOJEVE KAFSHËSH DHE MISHIT TË FRESKËT TË TYRE, TË CILAT HYJNË NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË NGA SHTETE TË CAKTUARA, SI DHE NGA
TERRITORE TË TJERA, NË ADMINISTRIM TË KËTYRE SHTETEVE”, E
MIRATUAR ME URDHRIN NR. 328, DATË 22.11.2011, TË MINISTRIT TË BUJQËSISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, neni 42, dhe nenit 55, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe VKM-së nr. 807, datë 20.12.2021, “Për miratimin, në parim, të marrëveshjes për bashkëpunimin në fushën e veterinarisë, sigurisë ushqimore dhe ushqimit për kafshë dhe fitosanitare në Ballkanin Perëndimor”,

URDHËROJ:

1. Pjesa I e aneksit I, ku përcaktohet lista e vendeve jashtë Bashkimit Evropian, territoreve ose pjesëve të tyre, të cilat lejohen të importojnë kafshë të gjalla drejt Republikës së Shqipërisë, ndryshohet sipas tabelës bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Pjesa I e aneksit II, ku përcaktohet lista e vendeve jashtë Bashkimit Evropian, territoreve ose pjesëve të tyre, të cilat lejohen të importojnë mish të freskët drejt Republikës së Shqipërisë, ndryshohet sipas tabelës bashkëlidhur këtij urdhri.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Politikave Veterinare në Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletore Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca

ANEKSI I
THUNDRAKËT

PJESA I

LISTA E VENDEVE JASHTË BASHKIMIT EUROPIAN, TERRITOREVE OSE PJESËVE
TË TYRE

Shteti	Kodi i territorit	Përshkrimi i territorit	Certifikata veterinare		Kushte të veçanta
			Modeli	GSH	
1	2	3	4	5	6
MK – Maqedonia e Veriut	MK-0	I gjithë vendi	BOV-X, BOV-Y, OVI-X, OVI-Y, POR-X, POR-Y, RUM, SUI.		
RS – Serbi	RS-0	I gjithë vendi	BOV-X, BOV-Y, OVI-X, OVI-Y, POR-X, POR-Y, RUM, SUI.		

ANEKSI II
MISHI I FRESKËT

PJESA II

LISTA E VENDEVE JASHTË BASHKIMIT EUROPIAN, TERRITOREVE DHE
PJESËVE TË TYRE

Kodi ISO dhe emri i vendit eksportues	Kodi i territorit	Përshkrimi i vendit eksportues, territorit ose pjesës së tij	Certifikata veterinare		Kushte të veçanta	Data e mbylljes	Data e hapjes ⁽²⁾
			Modeli	G SH			
1	2	3	4	5	6	7	8
MK – Maqedonia e Veriut	MK-0	I gjithë vendi	BOV, OVI, POR, EQU, RUF, RUW, SUF, SUW				
RS – Serbi	RS-0	I gjithë vendi	BOV, OVI, POR, EQU, RUF, RUW, SUF, SUW				